

Titulli i lëndës: TEORIA DHE KRITICIZMI NË ARKITEKTURË

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i lëndës:	Teoria dhe Kritikizmi në Arkitekturë
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Florina Jerliu, Asst. Denis Dalladaku, Asst. Endrit Mecini
Të dhënat kontaktuese:	florina.jerliu@uni-pr.edu , denis.dalladaku@uni-pr.edu , endrit.mecini@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda trajton konceptet, nocionet dhe kornizat teorike themelore të arkitekturës, duke ndjekur zhvillimin e mendimit arkitektural nga Vitruvi deri te debatet bashkëkohore. Përmes qasjeve teorike dhe kritike, studentët njihen me marrëdhënien midis estetikës, pushtetit, perceptimit dhe formës arkitekturale; me çështjet e origjinës dhe gjenezës së arkitekturës, traditës dhe thyerjes së saj; si dhe me mënyrën se si arkitektura ndërtohet, interpretohet dhe ripozicionohet në kohë. Lënda synon të zhvillojë të kuptuarit e arkitekturës si praktikë kulturore, si disiplinë teorike dhe si mjet reflektimi kritik mbi modernitetin, postmodernitetin dhe sfidat e kushteve bashkëkohore të projektimit.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të zhvillojë një kuptim të thelluar teorik dhe kritik të arkitekturës si disiplinë kulturore, intelektuale dhe praktike. Në veçanti, lënda synon: <ul style="list-style-type: none"> – Të hulumtojë idetë, konceptet dhe teoritë që qëndrojnë prapa formës arkitekturale dhe pamjes së ndërtesave, duke e pozicionuar teorinë e arkitekturës si mjet interpretimi dhe reflektimi kritik. – Të analizojë marrëdhënien dhe polaritetin midis njohurive të specializuara profesionale dhe vazhdimësisë së përvojës, kujtesës dhe njohurive kolektive të njerëzimit në ndërtimin e mjedisit të banueshëm. – Të zhvillojë një qasje kritike ndaj procesit krijues në arkitekturë, duke e kuptuar projektimin si ndërveprim midis traditave ndërtimore, koncepteve eksperimentale dhe gjykimeve estetike, si dhe si bazë për formësimin e gjykimit teorik dhe kritik të studentit të arkitekturës
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti/ja do të gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> – Të shpjegojë nocionet, konceptet dhe teoritë themelore të teorisë së arkitekturës, duke i vendosur ato në kontekst historik dhe bashkëkohor;

	<ul style="list-style-type: none"> – Të analizojë dhe interpretojë veprat arkitekturale përmes lenteve teorike dhe kritike, duke kuptuar marrëdhënien midis formës, funksionit, kuptimit dhe kontekstit kulturor; – Të vlerësojë në mënyrë kritike marrëdhënien midis traditës dhe inovacionit, teorisë dhe praktikës, si dhe ndikimin e tyre në procesin e projektimit; – Të argumentojë në mënyrë të strukturuar dhe të bazuar teorikisht gjykime estetike dhe kritike mbi arkitekturën, në formë të shkruar dhe verbale. – Të aplikojë mendimin teorik dhe kritik si mjet reflektimi në praktikën projektuese dhe në kuptimin e rolit të arkitekturës në shoqërinë bashkëkohore.
--	---

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	14	7
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie	1	10	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja për provimin final	2	7	14
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...			
Total			100

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive, diskutime të drejtuara, detyrë shtëpie individuale/grupore, lexim dhe interpretim i teksteve teorike, prezantime të punës së studentëve.
--------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<i>(Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%.</i> Vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit dhe përfshin komponentët në vijim Vijueshmëria e studentit, prezantimi dhe angazhimi aktiv në klasë 30%; Detyrat seminarike 40%, Vlerësimi nga testet 15% ose Provimi final 30%
------------------------------	--

Literatura primare:	Florina Jerliu (2026 – në botim) Teoria dhe Kriticizmi në Arkitekturë, UP Ch. Jencs , K.Kropf (2006)Theories and manifestoes of contemporary architecture, second edition, Academy Press Hanno-Walter Kruft (1996) History of Architectural Theory, from Vitruvius to the present , Princeton Architectural Press Hilde Heynen (2000) Architecture and modernity, A Critique, The MIT Press; Revised edition
----------------------------	---

	Joseph Rykwer (1981) On Adam's House in Paradise, The MIT Press; 2nd edition
Literatura shtesë:	<p>K. Michael Hays (Ed.) (200) Architecture Theory since 1968, The MIT Press</p> <p>Vitruvius (1960) The Ten Books on Architecture, Dover Publications: a) Libri 2/K1, b) Libri 3/K1, c) Libri 4K1</p> <p>Alberti (1991) On the art of building in Ten Books / De re aedificatoria: a) Libri 6/K4, b) Libri 9/K1</p> <p>Marc-Antoine Laugier (W. H. and A. H., 2009). An essay on architecture</p> <p>Mari Hvattum (2004) Gottfried Semper and the Problem of Historicism, Cambridge University Press (The Cult of Origins, ff 29-35)</p> <p>Andrea Palladio, R.S. , R. T. Transl. (2002) The four books on architecture, The MIT Press</p> <p>Revista e lëndës "ARKITEKTURA – Diskurs Teorik" numrat 1,2,3</p>

Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjëratës	Ushtrimet
Java 1:	Hyjre në lëndë	Prezentimi i detyrës / përcaktimi për temën e hulumtimit (ese)
Java 2:	Estetika dhe Pushteti: bazat e teorisë së arkitekturës	Diskutim i thelluar përmes temës së hulumtimit
Java 3:	Parimet e arkitekturës: Nga rregullat klasike te marrëdhëniet bashkëkohore	Diskutim i thelluar përmes temës së hulumtimit
Java 4:	Origjina e Arkitekturës: Pozicione teorike mbi fillet e arkitekturës	Diskutim i thelluar përmes temës së hulumtimit
Java 5:	Prezantim i studentëve: Struktura hulumtimit për miratim	
Java 6:	Materialiteti i arkitekturës: Nga lënda te kuptimi	Diskutim i thelluar përmes temës së hulumtimit
Java 7:	Hapësira: Hapësira si formë dhe hapësira e përjetuar	Diskutim i thelluar përmes temës së hulumtimit
Java 8:	Vendi: Hapësira e jetuar dhe hapësira anonime	Diskutim i thelluar përmes temës së hulumtimit
Java 9:	Imazhi i arkitekturës: Stili, brendi dhe kultura vizuale	Diskutim i thelluar përmes temës së hulumtimit
Java 10:	Prezantim i studentëve: Pozicionimi kundrejt pyetjeve hulumtuese	
Java 11:	Diskutim: Nga subjekti teorik, te Trupëzimi i arkitekturës, te ripozicionimi sot	Diskutim dhe pozicionimit teorik sot - kontekstualizim
Java 12:	Arkitektura në kohë: Nga interpretimi te trashëgimia	Diskutim i thelluar përmes temës së hulumtimit
Java 13:	E ardhmja (Futures) në kushtet metamoderne: Arkitektura pas krizës së moderitetit	Diskutim i thelluar përmes temës së hulumtimit
Java 14:	Prezantimet e studentëve: Prezantim final para dorëzimit	
Java 15:	Rekapitulim i lëndës	Dorëzimi final i detyrës

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Pjesëmarrja në ligjërata është e detyrueshme. Orët mësimore zhvillohen sipas orarit të përcaktuar dhe respektohet koha e fillimit dhe përfundimit të tyre. Lënda bazohet në ligjërata interaktive, prandaj inkurajohet dhe vlerësohet aktivisht bashkëbisedimi, diskutimi kritik dhe përfshirja e studentëve gjatë orës. Përdorimi i teknologjisë digjitale dhe pajisjeve të mençura lejohet dhe inkurajohet kur shërben për hulumtim, shfletim të materialeve dhe mbështetje të diskutimit akademik në zhvillim. Përdorimi i këtyre pajisjeve për aktivitete të tjera joakademike, si komunikimi personal apo rrjetet sociale, nuk është i lejuar gjatë orës mësimore.

Shënim | Nëse detyra seminarike e një studenti vlerësohet nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final